

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tensionet dhe përplasjet me policinë gjatë protestës së djeshme, 14 të arrestuar (EMRAT) – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/tensionet-dhe-perplasjet-me-policine-gjate-protestes-se-djeshme-15-te-arrestuar/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 17:48:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	2 shtator 2026, 06:51:24 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	290084b09b4fd3017b970b06c082b6d0d9bd5c938637c3735781313fecf7c413
TEKSTI	190f917396feb4cd9663b53d709d2b66be55c10a42691a7e7ed0b578a8729c23
PAMJA	c439880eda5f8660d7e9d72ca8cb6db6b948be278486960668a97aef3ad91767

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	90e8b9c40915b637ec916989d13088307a006af8935326c2c58d37101b12d1a5
E MËPARSHMJA	e9f5d0e717bde1c088d6bd753ad7cdf8a8dfeac51e4a8beb079c335d19d611fb
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/90e8b9c40915b637ec916989d13088307a006af8935326c2c58d37101b12d1a5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Ilustrim · Vizion Plus

Arrestohen 14 persona dhe procedohen penalisht në gjendje të lirë 3 të tjerë, në lidhje me protestën e zhvilluar më 1 shtator pranë Kryeministrit në Tiranë.

Sipas Policisë së Tiranës, grupi i protestuesve u grumbullua rreth orës 20:00 në rrugën "Ismail Qemali", në anën jugore të Kryeministrit, ku bllokuan hyrje-daljet e institucionit. Në atë kohë, në Kryeministri ndodheshin personalitete të larta shtetërore.

Policia vendosi një kordon sigurie për të penguar depërtimin e protestuesve brenda perimetrit të sigurisë. Për rreth 30 minuta, efektivët u kanë bërë thirrje protestuesve, përmes megafonit, që të shpërndareshin dhe të lironin rrugën.

Sipas policisë, protestuesve iu bë e ditur se veprimet e tyre ishin në kundërshtim me ligjin, pasi pengonin qarkullimin e mjeteve dhe lëvizjen e lirë të personaliteteve shtetërore.

Pavarësisht thirrjeve, protestuesit vijuan qëndrimin në rrugë dhe, sipas uniformave blu, kundërshtuan me forcë punonjësit e policisë.

Në momentin e zhvendosjes së tyre për lirim të hyrje-daljeve të Kryeministrit dhe të rrugës, disa prej protestuesve u ulën në rrugë dhe vijuan bllokimin, ndërsa dyshohet se goditën dhe shtynë efektivët.

Në përfundim të veprimeve policore, u arrestuan në flagrancë 14 persona,

5 "Dhembja e pjekurisë mund të shkaktojë tumor", kirurgu oral: Kur...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

Dritan Goxnaj, Junik Matosni, Edison Lika, Eriind Aimeta, Sokol Busni, Lulzim Gjini, Valtion Shameti, Florian Manarkolli, Desiderjo Alimucaj, Bora Mitrovica, Arvina Lleshi, Ylli Brahaj, Arben Kola dhe Aumiraldi Dalliu, ndërsa për tre të tjerë nisi procedimi penal në gjendje të lirë.

Materialet procedurale janë referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprat penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”, “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, “Prishja e qetësisë publike” dhe “Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit”.

Policia vijon veprimet procedurale për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të episodeve të ndodhura gjatë protestës.

#proteste



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



VENDI

Gjirokastër/ Flakët pranë stallave të...

Xhuljana Zhuleku

Dje
22:27



VENDI

Laçi triumfon ndaj Villaznisë, kurbinasit...

Xhuljana Zhuleku

Dje
20:40



VENDI

Përfshihet nga flakët banesa në Fushë-...

Xhuljana Zhuleku

Dje
20:18



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.